

DEKRET
Nr. 441, datë 5.12.2025

PËR DHËNIE DEKORATE

Në mbështetje të nenit 92, germa “ç”, nenit 93 të Kushtetutës, nenit 6, pika 1, të ligjit nr. 93/2022, “Për dekoratat në Republikën e Shqipërisë”, me propozim të Kryeministrit,

DEKRETOJ:

Neni 1

**Dhënien e dekoratës “Oficer i Madh i Urdhrit të Skënderbeut”
zotit Pëllumb Xhufi**

“Në vlerësim të kontributeve themelore në historishkrimin e periudhave më sfiduese të ndërtimit të identitetit arbëror-shqiptar, si një nga penat më autoritative dhe më të konsideruara në forumet kombëtare dhe ndërkombëtare shkencore në fushën e albanologjisë, si edhe për meritat e fituara prej dekadash në shërbim të shtetit, të debatit shoqëror dhe të interesit publik”.

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENT I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj